

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arsimi, faturë 277 mln euro: Shërbimet zënë rreth 3.3% të buxhetit të familjeve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/arsimi-fature-277-mln-euro-sherbimet-zene-rreth-33-te-buxhetit-te-familj-i585985
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:00:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 11:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9ff8ee22170a06e630ac469debcccaa280a7bbdce7e187fe8267d6f567d3e67
TEKSTI	7362f1b29177ca3d849ac6d249e52c89faae0d3065c932031d0d16634bc28a1d
PAMJA	3620276ec46e4803bf7a9f8e2d6403d5f830c90986dc561bea6a90351de9bec6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	48b724c2107e378e921c0a6c1cb567b2b2c70863fe479cc2581a660086284bdf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/48b724c2107e378e921c0a6c1cb567b2b2c70863fe479cc2581a660086284bdf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Suedi - Magdalena Andersson synon rikthimin e se majtes ne pushtetLuxair sjell Luksemburgun permes linjes se re me T Tirana International Airport12 dite ne spital, mo fundit

Arsimi, faturë 277 mln euro: Shërbimet zënë rreth 3.3% të buxhetit të familjeve



14 Shtator 2026, 13:10Sociale TEMA



Dita e parë e shkollës rikthen vëmendjen jo vetëm te bankat, librat dhe nxënësit, por edhe te fatura që arsimi përfaqëson për familjet shqiptare. “Scan Intel” ka analizuar të dhënat e Anketës së Buxhetit të Njësisë Ekonomike Familjare për të përllogaritur faturën që arsimi përfaqëson në buxhetin e familjeve shqiptare.

Sipas INSTAT, gjatë vitit 2024 një familje shqiptare, e përbërë mesatarisht nga 3.1 persona, shpenzoi për konsum rreth 93 mijë lekë në muaj. Në strukturën e këtyre shpenzimeve, zëri “Arsim” përbën 3.3% të totalit. Nga një përllogaritje e thjeshtë rezultojnë se rreth 3 mijë lekë në muaj nga buxheti i një familjeje shkojnë për këtë zë.

Po sa bëhet kjo shumë gjatë gjithë vitit?

Duke shumëzuar shpenzimin mujor me 12 muaj, rezultojnë se një familje shqiptare shpenzon mesatarisht rreth 36.8 mijë lekë në vit për arsim. Nëse marrim në konsideratë rreth 756 mijë familje, sipas rezultateve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, fatura bëhet shumë më e madhe.

Sipas përllogaritjeve të “Scan Intel”, familjet shqiptare shpenzojnë në total rreth 27.9 miliardë lekë në vit për arsim. Me një kurs mesatar këmbimi prej 100.7 lekësh për euro gjatë vitit 2024, kjo shumë përkthehet në rreth 277 milionë euro mesatarisht.

Arsimi zë një peshë më të madhe në Shqipëri se në BE

Të dhënat bëhen edhe më interesante nëse pesha e arsimit në buxhetin e familjeve shqiptare vendoset përballë mesatares së Bashkimit Europian. Sipas Eurostat, në vitin 2024 shërbimet e arsimit përbënin 0.9% të totalit të shpenzimeve të familjeve në Bashkimin Europian. Në Shqipëri kjo peshë rezultojnë 3.3%, ose rreth 3.7 herë më e lartë.

Kjo nuk do të thotë se familjet shqiptare shpenzojnë më shumë para në vlerë absolute sesa familjet europiane, por treguesi paraqet se arsimi zë një pjesë dukshëm më të madhe të buxhetit familjar në Shqipëri.

Duhet pasur parasysh gjithashtu se zëri “Arsim” në klasifikimin e INSTAT përfshin vetëm shërbimet e arsimit, nga arsimi parashkollor dhe fillor, te arsimi i mesëm, i lartë dhe kurset.

Pra, në këtë shumë nuk përfshihet e gjithë fatura që familjet përballojnë me nisjen e shkollës, pasi shpenzime si veshjet, këpucët apo produkte të tjera llogariten në kategori të veçanta të konsumit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

10:30 Sociale / 4 komete

Rozafa Fish City Apolloni hap portat

09:48 Sociale / 3 komete

Sa (shtrenjtë) kushton dita e parë e shkollës për familjet shqiptare?!

09:30 Sociale / 1 koment

Viti i ri shkollor nis me ndryshime, "Pas Shkolle" shtrihet në 408 shkolla dhe shtohen masat e sigurisë

09:10 Sociale / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.